




KOMUNA  
DRENAS

REPUBLIKA E KOSOVES  
KOMUNA GLOGOC  
MUNICIPAL GLOGOC

01 Nr. 400-12423

Më  
On. 18.03.2021



## Memorandum Bashkëpunimi

Në mes të:

### Komunës së Drenasit dhe Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP)

Me anë të këtij Memorandumi, Komuna e Drenasit dhe Instituti për Politika Zhvillimore pajtohen të bashkëpunojnë në realizimin e objektivave të projektit: "Integrimi i Objektivëve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) në procesin e dialogut komunal në Kosovë".

#### Qëllimi i bashkëpunimit

Komuna e Drenasit dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ndajnë të njëjtat parime të fuqizimit dhe promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor duke u bazuar në vlera demokratike, siç janë garantimi i të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta, dhe drejtësisë sociale dhe mjedisore.

Projekti në fjalë synon që të krijojë një hapësirë virtuale informuese/platformë për qytetarët e komunës së Drenasit, por jo vetëm, dhe të mundësojë paraqitjen grafike të përmbushjes së Objektivëve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-ve) në këtë territor komunal, saktësisht në 44 njësitë e tij.

Bashkëpunimi në mes të komunës dhe Institutit INDEP arrihet me qëllim të përmirësimit të procesit të dialogut institucional në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm dhe krijimit të hapësirës për veprim të përbashkët për OZHQ-të dhe Agjendën 2030 mes palëve të interesuara. Duke e ditur se avancimi i Agjendës 2030 në nivel komunal do të thotë kushte më të mira ekonomike, sociale dhe mjedisor për gjithë komunitetin, INDEP synon të krijojë një platformë për përcjelljen e përmbushjes së OZHQ-ve në Komunën e Drenasit e cila do të portretizojë mirëqenien e komunës. Kjo njëkohësisht do të lehtësojë procesin e monitorimit të zbatimit të OZHQ-ve në nivelin lokal dhe do të informojë në kohë reale palët e interesuara në statusin e komunës në këtë drejtim.

Palët nënshkruese të këtij memorandumi pajtohen të shohin mënyra shtesë të promovimit të platformës monitoruese të OZHQ-ve dhe të realizimit të objektivëve final të këtij memorandumi.

RDP

A.G.



**KOMUNA  
DRENAS**



### **Obligimet e palëve nënshkruese**

Ky Memorandum Bashkëpunimi vendosë bazat e bashkëpunimit në mes të Komunës së Drenasit dhe Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Pavarësisht obligimeve të marra me këtë memorandum, palët pajtohen që bashkëpunimi nuk do të kufizohet vetëm me elementet në vazhdim.

Komuna e Drenasit zotohet të:

- Ofrojë të dhëna që prekin objektivet, qëllimet dhe indikatorët e zhvillimit të qëndrueshëm në komunën e Drenasit në periudha vjetore të caktuara në bazë të të dhënave në dispozicion. Të dhënat mund të ndahen në 17 fushat e OZHQ-ve ose mund të kategorizohen në tema të veçanta, sipas dakordimit të palëve gjatë evidentimit të të dhënave.

INDEP zotohet të:

- Paraqesë në mënyrë të drejtë e të paanshme informatat e ofruara nga komuna e Drenasit,
- Të krijojë dhe mirëmbajë financiarisht platformën e OZHQ-ve,
- Të promovojë dhe kontribuojë në informimin e të gjithë komunitetit për përmbushjen e OZHQ-ve në komunën e Drenasit.

### **Kohëzgjatja**

Ky memorandum bashkëpunimi zgjatë dymbëdhjetë, (12) muaj që nga data e nënshkrimit.

Pas përfundimit të kohëzgjatjes së memorandumit, palët do të ulen të bisedojnë mbi zgjatjen e këtij bashkëpunimi, vlerësimin e performancës së platformës dhe mirëmbajtjes së saj në vitet në vazhdim.

Drenas, 16 mars 2021

Ramiz Lladrovci

Kryetar i Komunës së Drenasit



Burim Ejupi

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)